



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC

**SHPLLJE PËR NËPUNËS CIVIL PËR LËVIZJE PARALELE DHE
PRANIMIN NË SHËRBIMIN CIVIL NË KATEGORINË
EKZEKUTIVE**

Pogradec, më 27/01/ 2016

Në zbatim të nenit 22 dhe të nenit 25, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, të Vendimit Nr. 243, datë 18/03/2015, të Këshillit të Ministrave, Njesia e Menaxhimit të Burimeve Njerezore pranë Bashkisë Pogradec shpall procedurat e lëvizjes paralele dhe të pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive, për pozicionet:

a. 2 (Dy) pozicione - Specialist për Kulturën, Rininë dhe Sportet - kategoria e pagës IV – b, Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve

Pozicionet më sipër, u ofrohen fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele. Vetëm në rast se këto pozicione, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezultojnë vakante, atëherë janë të vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit nga jashtë shërbimit civil. Për të gjitha procedurat (lëvizje paralele dhe pranim nga jashtë shërbimit civil) aplikohet në të njëjtën kohë.

Afati për dorëzimin e dokumentave për LËVIZJE PARALELE: 06.02.2017

Afati për dorëzimin e dokumentave për PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL : 28.02.2017

Intervista e strukturuar me gojë, për kandidatët që kualifikohen për lëvizjen paralele, do të zhvillohet në datën **08.02.2017**, pranë Zyrës së Burimeve Njerezore, të Bashkisë Pogradec. Ndërsa konkursi me shkrim, për pranimin në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive, do të zhvillohet në datën **03. 03.2017**, pranë ambjenteve të Bashkisë Pogradec.

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionet e mësipërme është :

Specialist për Kulturën, Rininë dhe Sportet

- Ushtron aktivitet e planifikuara ,duke udhëhequr burimet lokale ,kulturore të rinisë dhe të sporteve
- Propozon dhe përgatit aktivitet kulturore ,rinore dhe sportive
- Bën organizimin dhe përkujdesjen për shënimin e datave me rëndësi dhe vlera të dëshmuara historike
- Organizon,debate ,tryeza me shtresat e shoqërisë civile dhe organet shtetërore me qëllim të avancimit,zhvillimit dhe promovimit, të fushës së kulturës ,preokupimet,problematikën dhe aktivitetet e rinisë dhe të sporteve në të gjitha degët
- Të krijojë projektet të cilat luajnë një rol të rëndësishem për zhvillimin në fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

Lëvizja paralele

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil

Kushtet për lëvizjen paralele dhe kriteret e vecanta

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- a- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda së njëjtës kategori
- b- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi
- c- Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mirë”

Kërkesat e përgjithshme për pranimin në shërbimin civil dhe kërkesat e posaçme:

-Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtjeje penale me dashje

- Të mos jetë marrë ndaj tij masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil
- Të ketë vleresimin e fundit ‘mirë’ ose ‘shumë mirë’

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme,si më poshtë:

- Të zotërojnë diplomë të arsimit të lartë
- Preferohet të ketë eksperiencë pune, në fushat përkatëse

DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

- Jetëshkrimi (CV) plotësuar në përputhje me formatin europian
- Fotokopje të diplomës dhe listës së notave (përfshirë edhe diplomën bachelor)
- Fotokopje të librezës së punës nëse ka (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë)
- Fotokopje të letërnjoftimit(ID)
- Vërtetim të gjendjes shëndetësore
- Vërtetim të gjendjes gjyqësore/vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore
- Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi (nëse është në marrëdhënie pune)

Rezultatet për fazën e verifikimit paraprak

Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore do të shpallë në faqen zyrtare të internetit, në portalin Shërbimi Kombëtar i Punësimit dhe pranë Zyrës së Punës listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për lëvizjen paralele. Po në të njëjtën datë do të njoftohen nga Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore kandidatët të cilët nuk kanë plotësuar kushtet dhe kërkesat e posaçme.

Kandidatët do të testohet në lidhje me:

- Ligj Nr. 9376, datë 21.4.2005 "Për sportin"
- Ligj nr.10 352, datë 18.11.2010, "Për Artin dhe Kulturën"
- Ligj nr.93/2015 “Për Turizmin”
- Ligj Nr. 152/2013 “Për nënpunësin Civil”;

- Ligj Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”
- Ligj nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”

Mënyra e vlerësimit të kandidatëve për lëvizjen paralele

Kandidatët për lëvizjen paralele në këto pozicione pune do të vlerësohet si më poshtë:

- 1) **40** pikë për dokumentacionin e dorëzuar ndarë në:
 - 1.1) **20** pikë për përvojën
 - 1.2) **10** pikë për trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën përkatëse
 - 1.3) **10** pikë për certifikimin pozitiv
- 2) **60** pikë intervista me gojë

Mënyra e vlerësimit të kandidatëve për pranimin në shërbimin civil

Kandidatët do të vlerësohen në bazë të dokumentacionit të dorëzuar, përvojës, trajnimeve, kualifikimeve në lidhje me fushën si certifikimi dhe vlerësimet individuale në punë.

- 1) **15** pikë për dokumentacionin e dorëzuar
- 2) **60** pikë për testimin me shkrim
- 3) **25** pikë për intervistën e strukturuar me gojë

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve , Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore do të shpallë fituesin në stendat e informimit të publikut, në faqen zyrtare të Bashkisë Pogradec dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, për rezultatet nëpërmjet (adresës së e-mailt). Brenda tre ditëve kalendarike nga njoftimi individët kanë të drejtë të paraqesin ankesa me shkrim pranë zyrës së Burimeve Njerëzore.